

Wesley Clark  
konfirmohet dëshmitar  
në mbrojtjen e Thaçit



Na ndiqni edhe në:  
[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)  
facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# ZGJEDHJE MILIONËSHE, TRANSPARENÇË MINIMALE

Zgjedhjet në Kosovë nuk kushtojnë vetëm vota - ato kushtojnë miliona euro. Vetëm për parlamentaret e 9 shkurtit partitë shpenzuan rreth katër milionë euro. Por, problem mbetet transparenca: shifrat nuk përputhen gjithmonë me realitetin dhe mekanizmat për kontrollin e shpenzimeve janë të dobët

## AKTUALE



BE-ja DËSHTON TË ARRIJË  
MARRËVESHJE PËR PËRDORIMIN  
E ASETEVE TË NGRIRA RUSE  
PËR UKRAINËN F.2

KAMBERI KËRKON ANGAZHIM MË  
INTENSIV TË SHBA-SË NË LUGINËN  
E PRESHEVËS F.3

ISH-DEPUTETËT AUSTRIAKË  
VIZITOJNË UNIVERSITETIN E  
PRISHTINËS F.7

## EKONOMI



RAPORTI I GAP-it ZBULON  
PABARAZI GJINORE DHE ETNIKE  
NË PROGRAMET E MBËSHTETJES  
PËR BIZNESE F.8

SHAHINI: MESAZHET NGA LONDRA  
JANË TË QARTA, RAJONI DUHET TA  
PËRSHPEJTOJË INTEGRIMIN  
EKONOMIK F.8

## SPORT



DRITA VAZHDON E PAMPOSHTUR  
NË LIGËN E KONFERENCËS F.11



SHTATË DITË FUSHATË ZGJEDHORE  
PËR BALOTAZH F.3

KOSOVA NË UDHËKRYQ:  
QEVERI APO ZGJEDHJE  
TË PARAKOHSHME? F.6



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Perizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princsha-ks.com](http://www.princsha-ks.com)

**Buniamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · CUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjbiznesi.com](http://www.kolegjbiznesi.com)  
info@kolegjbiznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# BE-ja DËSHTON TË ARRIJË MARRËVESHJE PËR PËRDORIMIN E ASETEVE TË NGRIRA RUSE PËR UKRAINËN

**BRUKSEL, 24 TETOR** - Udhëheqësit e Bashkimit Evropian nuk arritën marrëveshje për përdorimin e aseteve të ngrira shtetërore të Rusisë për ta ndihmuar Ukrainën, pasi Belgjika - vendi ku mbahet pjesa më e madhe e këtyre fondeve - ngriti shqetësime ligjore dhe teknike. Në një takim të mbajtur në Bruksel më 23 tetor, udhëheqësit kërkuan nga Komisioni Evropian ta vazhdojë punën për një plan për përdorimin e rreth 140 miliardë eurove nga rezervat e ngrira të Bankës Qendrore të Rusisë, për ta mbështetur Kievin për nevojat e tij ushtarake dhe buxhetore, por disa diplomatë thanë se marrëveshja përfundimtare mbetet ende e paarritshme. “Udhëheqësit evropianë u zotuan se nevojat financiare të Ukrainës do të mbulohen për dy vjetët e ardhshëm”, tha presidenti i Këshillit Evropian, Antonio Costa, pas samitit. “Rusia duhet ta marrë këtë mesazh. Ukraina do të ketë burimet financiare që i nevojiten për t’u mbrojtur nga agresioni rus”, shtoi ai. Costa theksoi se është e mundur të zgjidhen çështjet teknike për të cilat nevojitet sqarim, për ta

bërë të mundur përdorimin e aseteve të ngrira ruse, duke nënvizuar se “kjo zgjidhje është e arritshme”. Bashkimi Evropian i ngriu rreth 200 miliardë euro nga asetet e Bankës Qendrore të Rusisë pas pushtimit të Ukrainës nga Moska në vitin 2022. Deri më tani BE-ja ka përdorur vetëm interesimin e krijuar nga këto fonde për ta mbështetur Ukrainën në mbrojtjen kundër Rusisë. Moska paralajmëroi më 23 tetor se çdo veprim me asetet ruse pa pëlqimin e saj është “i pavlefshëm nga pikëpamja e së drejtës ndërkombëtare dhe ajo kontraktuale”, si dhe do të “nxisë përgjigje të dhimbshme”. Blloku evropian e zhvilloi këtë skemë huaje pasi u përball me trysni për të siguruar ndihmë shtesë për Kievin për shkak se mbështetja amerikane u ngadalësua pas kthimit të Donald Trumpit në pushtet. Sipas skemës - për të cilën Komisioni Evropian këmbëngul se nuk do t’i prejë asetet sovraane ruse - Bashkimi Evropian do të merrte hua fonde nga kompania Euroclear. Pastaj, blloku do t’ia jepte këto para Ukrainës si hua, e cila do të



duhej ta shlyente huan vetëm nëse Rusia paguan për dëmet që ka shkaktuar në Ukrainë. Pjesa më e madhe e aseteve në fjalë ndodhet në Belgjikë, kryeministri i së cilës, Bart De Wever, tha se ende ka disa shqetësime. De Wever ka këmbëngulur se, për të ecur përpara, Belgjika ka nevojë për garanci të forta nga të gjitha shtetet e tjera të BE-së se do ta ndajnë përgjegjësinë, nëse Moska kërkon kompensim. Ai, gjithashtu, dëshiron që vendet e tjera të BE-së të premtojnë se do të fillojnë t’i përdorin asetet e ngrira ruse në vendet e tyre. “Jam vetëm Belgjika e vogël dhe e varfër; e vetmja gjë që mund të bëj është të tregoj ku janë

problemet dhe të kërkoj me butësi zgjidhje për problemin thelbësor”, tha De Wever për gazetarë pas samitit. Ai paralajmëroi se, përderisa këto kushte nuk përmbushen, ai do të bëjë gjithçka që është e mundur “politikisht dhe ligjorisht për ta ndaluar këtë vendim”. Konkluzionet e samitit, të cilat u miratuan nga të gjitha shtetet anëtare përveç Hungarisë, u zbutën për shkak të kundërshtimeve nga Belgjika. Teksti përfundimtar nuk përmendi drejtpërdrejt huan, por ftoi Komisionin të paraqesë “opsione për mbështetje financiare” për Ukrainën për vitet 2026 dhe 2027.

Këto opsione do t’u paraqiten udhëheqësve në samitin e ardhshëm në dhjetor. Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, i cili mori pjesë në samit si i ftuar, megjithatë e vlerësoi takimin duke thënë se ai “solli rezultate të mira”. “Bashkimi Evropian garantoj se ndihma financiare për Ukrainën do të vazhdojë jo vetëm vitin e ardhshëm, por edhe në vitin 2027”, tha Zelensky në platformën X. “Ky është vendim i rëndësishëm unanim. Ne kemi siguruar mbështetje politike për përdorimin maksimal të aseteve të ngrira ruse për t’u mbrojtur nga agresioni rus”, shtoi ai. Kancelari i Gjermanisë, Friedrich Merz, një nga mbështetësit e kësaj skeme, tha se pret që Komisioni të paraqesë opsione të ndryshme para samitit të ardhshëm të BE-së. “Ne po rrisim trysninë për ta bërë palën ruse t’i pranojë bisedimet, në mënyrë që armët të heshtin në Ukrainë përfundimisht”, tha Merz. Bisedimet në BE u zhvilluan një ditë pasi blloku miratoi paketën e 19 të sanksioneve ndaj Rusisë dhe pasi Shtetet e Bashkuara vendosën sanksione ndaj dy kompanive të mëdha të naftës ruse. (REL)

## TRUMPI THOTË SE JANË NDËRPRERË TË GJITHA BISEDIMET TREGTARE ME KANADANË

**UASHINGTON, 24 TETOR** - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, njoftoi të enjten vonë se të gjitha bisedimet tregtare me Kanadanë janë ndërprerë përfundimisht shkaku i asaj që ai e quajti reklamë mashtruese, në të cilën ish-presidenti i ndjerë, Ronald Reagan, fliste negativisht për tarifën. Trumpi vendosi tarifa ndaj çelikut, aluminit dhe automjeteve kanadeze në fillim të këtij viti, duke bërë që Otava të përgjigjej me masa të ngjashme.

ShBA-ja dhe Kanadaja kanë qenë duke biseduar tash e disa javë për një marrëveshje të mundshme në sektorët e çelikut dhe aluminit. “Bazuar në sjelljen e tyre skandaloze, të gjitha bisedimet tregtare me Kanadanë janë ndërprerë”, shkroi Trumpi në rrjetin social “Truth Social”. Doug Ford, kryeministër i provincës kanadeze Ontarios, tha në fillim të kësaj jave se reklama nga provinca e tij me mesazhe kundër tarifave i kishte tërhequr vëmendjen Trumpit. Reklama e shfaq Reaganin, i cili



ishte republikan, duke i kritikuar tarifën ndaj mallrave të huaja dhe duke thënë se ato çojnë në humbjen e vendeve të punës dhe në luftëra tregtare. “Kam dëgjuar se presidenti e pa reklamën tonë. Jam i sigurt se nuk ishte shumë i kënaqur”, tha

Ford të martën. Fondacioni Presidential Ronald Reagan tha në një komunikatë të enjten vonë se reklama nga Qeveria e Ontarios po “përdor audio dhe video të përzgjedhura” të Reaganit dhe se fondacioni po shqyrton opsionet ligjore. “Reklama e shtrembëron fjalimin presidencial të Ronald Reaganit në radio [të vitit 1987], dhe Qeveria e Ontarios nuk ka kërkuar as marrë leje për ta përdorur apo redaktuar atë material”, thuhet në deklaratë.

Qeveria e Kanadasë nuk ka folur ende lidhur me vendimin e Trumpit. Kryeministri i Kanadasë, Mark Carney, u tha gazetarëve të enjten se Kanadaja nuk do të lejojë që ShBA-ja të ketë qasje të padrejtë në tregjet e saj, nëse dështojnë bisedimet për marrëveshjet e ndryshme tregtare me Uashingtonin. Vitin e ardhshëm ShBA-ja, Kanadaja dhe Meksika pritet ta rishikojnë marrëveshjen e tyre nga viti 2020 për tregti të lirë kontinentale.

## Erdogani: ShBA-ja t’i bëjë trysni Izraelit për zbatimin e armëpushimit në Gazë

**ANKARA, 24 TETOR** - Presidenti i Turqisë, Tayyip Recep Erdogan, ka thënë të premten se Shtetet e Bashkuara dhe vende të tjera duhet të bëjnë më shumë për ta detyruar Izraelin ta ndalë shkeljen e marrëveshjes së armëpushimit në Rripin e Gazës. Ai theksoi se ato duhet të përdorin edhe sanksione apo ta ndalin shitjen e armëve në Izrael.

Turqia, anëtare e NATO-s dhe një nga kritiket më të zëshme të luftës së Izraelit në Gazë, u është bashkuar bisedimeve për armëpushim si ndërmjetëse, pasi më parë ishte përfshirë kryesisht tërthorazi. Roli i saj i shtuar erdhi pas një takimi muajin e kaluar ndërmjet Erdoganit dhe presidentit amerikan Donald Trump në Shtëpinë e Bardhë.

“Si Turqi, po bëjmë gjithçka që mundemi për ta siguruar armëpushimin. Hamasi po e respekton armëpushimin dhe madje po e shpreh haptas zotimin për këtë. Ndërkohë, Izraeli po vazhdon ta shkelë armëpushimin”, tha Erdogani për gazetarë. “Bashkësia ndërkombëtare, veçanërisht Shtetet e Bashkuara, duhet të bëjnë më shumë për të siguruar që Izraeli i zbaton

plotësisht armëpushimin dhe marrëveshjen”, tha ai, sipas një komunikate nga zyra e tij të premten. “Izraeli duhet të detyrohet t’i mbajë premtimet e veta përmes sanksioneve dhe ndalimit të shitjeve të armëve”, sipas tij. Ankaraja ka thënë se do t’i bashkohet një “task-force” që do ta mbikëqyrë zbatimin e armëpushimit, dhe se forcat e saj të armatosura mund të



shërbejnë në kapacitete ushtarake apo civile sipas nevojës. Ajo, gjithashtu, ka shprehur gatishmëri për të ndihmuar në rindërtimin e enklavës.



## Shtatë ditë fushatë zgjedhore për balotazh

PRISHTINË, 24 TETOR - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vendosur që aktivitetet zgjedhore për raundin e dytë të zgjedhjeve lokale për kryetarë të komunave do të jenë nga 3 deri më 9 nëntor 2025. Sipas vendimit të KQZ-së, për miratimin e planit të aktiviteteve

fushata zgjedhore për subjektet politike dhe kandidatët që garojnë në raundin e dytë do të fillojë më 3 nëntor dhe do të përfundojë në orën 06:59 më 9 nëntor. Po sipas vendimit të KQZ-së, nga 26 tetori deri më 29 nëntor është planifikuar që të bëhet dërgimi i

fletëvotimeve për votuesit jashtë Kosovës të cilët janë regjistruar gjatë raundit të parë dhe që u takojnë komunave ku do të mbahet raundi i dytë. Ndërkaq, votimi përmes postës do të fillojë më 27 tetor dhe do të përfundojë më 8 nëntor 2025. KQZ-ja do t'u japë mundësi

subjekteve politike që do të garojnë në raundin e dytë që të akreditojnë vëzhgues shtesë dhe të konfirmojnë vëzhguesit e akredituar. Kjo mund të bëhet nga data 28 tetor deri më 3 nëntor. Edhe mediet, OJQ-të, organizatat ndërkombëtare dhe përfaqësuesit diplomatikë, do të



duhet t'i konfirmojnë vëzhguesit e tyre nga 31 tetori deri më 3 nëntor 2025.

# OSMANI: ËSHTË KOHA QË BALLKANI PERËNDIMOR TË SHIHET SI POTENCIAL E JO SI BARRË

PRISHTINË, 24 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, tha se është koha që rajoni i Ballkanit Perëndimor të shihet nga Bashkimi Evropian si potencial e jo si barrë. Gjatë një universitet në Berlin, Osmani tha se procesi i zgjerimit të BE-së duhet të shihet si domosdoshmëri strategjike e bllokut evropian dhe jo të varet nga çështjet politike që kanë shtetet individuale. “Mendoj se zgjerimi duhet të shihet nga një pikëpamje më e gjerë. Nëse e shihni Ballkanin Perëndimor si rajon, mendoj se është koha që ne të shihemi si potencial e jo si barrë”, tha Osmani. Ajo u pyet lidhur me një propozim të paraqitur së voni që shtetet e reja anëtare mund të pranoheshin, nuk do të kishin të drejta të plota si dhe nëse e përkrah heqjen e fuqisë së vetos brenda Këshillit të BE-së. Ajo tha se e favorizon këtë sepse, shtoi, “kemi parë shpesh kur një vend



anëtar bllokun vullnetin e gjithë BE-së”. Presidentja e Kosovës tha se BE-ja duhet ta shohë Ballkanin Perëndimor si potencial, pasi rajoni, sipas saj, ofron tri potenciale të rëndësishme: potencialin njerëzor, atë ekonomik dhe atë të sigurisë. “Sa më shumë që rajoni ynë lëviz drejt BE-së, aq më shumë do të ketë paqe dhe siguri. Dhe kjo

është e mirë për gjithë BE-në dhe kontinentin”, tha Osmani. Presidentja Osmani tha se gjithmonë ka thënë se ka mbështetur që procesi i zgjerimit të bazohet në merita dhe shtetet duhet ta përshtatin politikën e tyre të jashtme dhe të sigurisë me të BE-së. Kosova, tha ajo, e ka përshtatur 100 për qind politikën e saj, duke përmendur sanksionet ndaj Rusisë për shkak të luftës në

Ukrainë. Megjithatë, ajo tha se në rajon ka shtete që nuk veprojnë kështu - referencë për Serbinë, e cila, pavarësisht se ka mbështetur rezoluta të Kombeve të Bashkuara që dënojnë agresionin rus në Ukrainë, shteti refuzon të vendosë sanksione ndaj Moskës. “Nuk mund të ulesh në dy karrige njëherësh, nuk duhet të ketë një zonë gri”, porositi Osmani.

Nga shtetet e Ballkanit, vetëm Kosova është prapa në rrugën evropiane, pasi është vendi i vetëm që nuk ka as statusin e vendit kandidat. Prishtina ka dorëzuar aplikimin për anëtarësim në BE në dhjetor të vitit 2022. Megjithatë, ky aplikim ende nuk ka kaluar as në fazën e parë formale, atë të shqyrtimit nga Këshilli i BE-së dhe më pas dërgimit për opinion në Komisionin Evropian. Gjatë ligjëratës në këtë universitet, por edhe në bashkëbisedimin që pasoi, Osmani përsëriti akuzat se Rusia po tenton t'i minojë demokracitë në Evropë. “Serbia, bashkëpunëtorja e Rusisë, vazhdimisht tenton ta minojë sovranitetin e Kosovës përmes destabilizimit, dezinformimit dhe duke mbështetur grupe kriminale dhe terroriste”, tha Osmani. Osmani së voni ka përsëritur qëndrimin e saj se Serbia dhe Rusia paraqesin kërcënim për Kosovën.

## KAMBERI KËRKON ANGAZHIM MË INTENSIV TË SHBA-së NË LUGINËN E PRESHEVËS



PRISHTINË, 24 TETOR - Një delegacion i shqiptarëve të Luginës së Preshevës, i udhëhequr nga deputeti Shaip Kamberi, ka zhvilluar një takim me kongresmenin Keith Self, kryetar i Nënkomitetit për Evropën në Komisionin për Punë të Jashtme të Dhomës së Përfaqësuesve. Në Dallas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës ata thanë se biseduan gjerësisht “për gjendjen reale në Luginën e Preshevës, përtej narrativave zyrtare të Beogradit” dhe treguan se po kërkojnë barazi - të njëjtat standarde që Serbia i kërkon për serbët në Kosovë. “Hapur folëm për pozitën e

vështirë të shqiptarëve në Preshevë, Bujanoc dhe Medvegjë. Militarizimin e zonës e moszbatimin e marrëveshjeve të nënshkuara nga Serbia, që nga Marrëveshja Kornizë e vitit 2001, për pasivizimin e adresave, që po përdoret si mjet administrativ për fshirjen e shqiptarëve nga regjistrat civilë, si dhe diskriminimin dhe marginalizimin sistematik në institucione publike, arsim dhe punësim. Në takim kërkova edhe mundësinë e angazhimit më intensiv të Shteteve të Bashkuara në Luginën e Preshevës përmes mbështetjes institucionale, monitorimit të

situatës dhe përfshirjes më të drejtpërdrejtë në çështjet e të drejtave të njeriut”, ka shkruar Kamberi në “Facebook”. Ai ka theksuar se Lugina e Preshevës kërkon barazi, të njëjtat standarde që Serbia i kërkon për serbët në Kosovë, duhet të zbatohen edhe për shqiptarët në Serbi. “Falënderim për kongresmenin Self për hapjen, mirëkuptimin dhe gatishmërinë për ta dëgjuar zërin e shqiptarëve të Luginës! Avokimi ynë për drejtësi dhe qytetari të barabartë vazhdon, me partnerët tanë amerikanë që ndajnë të njëjtat vlera demokratike”, ka shkruar Kamberi.

## Maqedonci takohet me komandantin e KFOR-it, flasin rreth situatës së sigurisë

Prishtinë, 24 tetor - Ministri në detyrë i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, ka pritur në takim komandantin e KFOR-it, Ozkan Ulutas. Maqedonci ka thënë se me Ulutas kanë diskutuar rreth situatës së

sigurisë. “Prita sot në takim komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Ozkan Ulutaş. Diskutuam rreth situatës së sigurisë në nivel regional dhe global. Gjithashtu shpreha dhe gatishmërinë për vazhdimin e

koordinimit të ndërsjellë për çështjet me interes të përbashkët në kuadër të zhvillimeve aktuale dhe ndikimit të tyre në mjedisin e sigurisë”, ka shkruar Maqedonci në “Facebook”.







# ZGJEDHJE MILIONËSHE, TRANSPARENCË MINIMALE

Zgjedhjet në Kosovë nuk kushtojnë vetëm vota - ato kushtojnë miliona euro. Vetëm për parlamentaret e 9 shkurtit, partitë shpenzuan rreth katër milionë euro. Por, problem mbetet transparenca: shifrat nuk përputhen gjithmonë me realitetin dhe mekanizmat për kontrollin e shpenzimeve janë të dobët

**PRISHTINË, 24 TETOR** - Gati katër milionë euro u shpenzuan nga 28 subjekte politike gjatë fushatës për zgjedhjet e 9 shkurtit për Kuvendin e Kosovës.

Vetëm pesë partitë kryesore - Lëvizja Vetëvendosje, Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës/Nisma dhe Lista Serbe - shpenzuan rreth 3.6 milionë euro, sipas të dhënave që publikoi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Ligji kërkon që partitë t'i dorëzojnë raportet financiare brenda 30 ditëve nga certifikimi i rezultateve.

Më 12 tetor u mbajtën edhe zgjedhjet lokale, ndërsa raundi i dytë i tyre do të mbahet më 9 nëntor. Të dhënat për këto fushata do të publikohen më vonë, por në zgjedhjet e kaluara lokale, më 2021, pesë partitë kryesore shpenzuan rreth 1.3 milion euro.

Përfaqësues të shoqërisë civile paralajmërojnë se shumata reale të shpenzuara mund të jenë shumë më të larta, duke i tejkaluar ato të raportuara në KQZ. Kjo edhe rrit shqetësimin për mungesën e transparencës dhe kontrollit mbi paratë e qytetarëve.

Mexhide Demolli, drejtoreshë

ekzekutive e Lëvizjes FOL - organizatë që promovon llogaridhënien në institucionet publike - thotë se partitë politike në Kosovë vazhdojnë të jenë jotransparente në raportimin e mjeteve të shpenzuara gjatë fushatave zgjedhore. Sipas saj, është absurde që në raportet financiare të disa prej partive më të mëdha, të hyrat e deklaruar të jenë dukshëm më të ulëta se shpenzimet për periudhën përkatëse.

Sipas të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nga 16 gushti 2024 deri më 9 shkurt 2025 LV ka deklaruar të hyra mbi 1.1 milion euro, PDK-ja mbi 559 mijë euro, LDK-ja mbi 94 mijë euro dhe AAK-ja mbi 18 mijë euro. “Fatkeqësisht, ende mungon një mekanizëm i qartë dhe efektiv për monitorimin e shpenzimeve gjatë fushatës. Kjo është një nga problematikat kryesore që duhet të adresohet urgjentisht nga KQZ-ja”, thotë Demolli, duke shtuar se vetëm një sistem transparent do të sigurojë raportime reale, e jo “sipas dëshirës” së partive.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk iu përgjigj interesimit të Radios Evropa e Lirë se a ka ndonjë mekanizëm për monitorimin e shpenzimeve të partive gjatë fushatave

zgjedhore.

Profesori i ekonomisë në Universitetin e Prishtinës, Berim Ramosaj, e konsideron procesin e deklarimit të shpenzimeve nga partitë politike si një hap pozitiv drejt transparencës financiare. Megjithatë, ai shpreh dyshime serioze për saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të raportuara. Sipas Ramosajt, kostoja e fushatave zgjedhore është rritur ndjeshëm vitet e fundit, kryesisht për shkak të përdorimit të gjerë të rrjeteve sociale dhe zhvillimit të marketingut politik.

## Sa kanë të drejtë të shpenzojnë dhe nga i sigurojnë mjetet?

Sipas ligjit në fuqi, subjektet politike në Kosovë mund të shpenzojnë deri në mbi dy milionë euro gjatë një fushate zgjedhore, ose jo më pak se një euro për çdo votues të regjistruar. Ky kufi është përcaktuar me Rregulloren e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), e miratuar në gusht të vitit të kaluar.

Në zgjedhjet e mëparshme, ky prag ishte 0.50 centë për votues - çka tregon një rritje të konsiderueshme të kufirit ligjor të shpenzimeve.

Partitë politike financohen nga dy burime kryesore: nga buxheti i shtetit dhe nga donatorët e jashtëm.

Financimi publik sigurohet çdo vit përmes Programit për Mbështetjen e Subjekteve Politike, i cili mbulon një pjesë të shpenzimeve të tyre operative dhe elektorale.

## Institucionet ende të bllokuara

Edhe më shumë se tetë muaj pas mbajtjes së zgjedhjeve parlamentare, institucionet e reja të Kosovës nuk janë ende plotësisht funksionale për shkak të mosmarrëveshjeve politike. Derisa bisedimet për formimin e qeverisë vazhdojnë të zvarriten, në skenë janë shfaqur diskutime edhe për një palë zgjedhje të parakohshme - çka e bën edhe më shqetësuese koston e fushatave. “Janë shpenzime të tepërta. Partitë parlamentare marrin mjete nga buxheti i shtetit, nga donacionet dhe kontributet e qytetarëve e bizneseve, por vendi ende nuk ka qeveri funksionale. Madje nuk dihet ende se sa është shpenzuar në zgjedhjet lokale, e ne mund të përballemi sërish me zgjedhjet të parakohshme”, thotë Demolli për Radion Evropa e Lirë. Ajo dhe Ramosaj vlerësojnë se partitë kanë shpenzuar shumicën e mjeteve të marra përmes Fondit të Qeverisë, ndërsa tani pritet të mbështeten gjithnjë e më shumë në donacione dhe kontribute private.

Por, problem mbetet transparenca.

Demolli thekson se donacionet që vijnë nga kompani publike shpesh mbeten të padeklaruara - një praktikë që është vërejtur edhe në zgjedhjet e kaluara. “Sapo marrin pushtetin - në nivel qendror apo lokal - këto kompani shpërblehen përmes tenderëve të ndryshëm”, thotë ajo, por nuk ofron ndonjë shembull konkret. “Fatkeqësisht, kjo praktikë nuk po zhduket por, përkundrazi, po përsoset mënyra se si jepen këto donacione dhe si fshihet publikimi i tyre”, shton ajo.

Edhe Ramosaj e sheh këtë si një rreth të mbyllur interesash politike dhe ekonomike. Sipas tij, bizneset private rrallëherë japin mbështetje financiare pa llogaritur kthimin e investimit. Asnjë donator, thotë ai, nuk jep mjete pa parë “koeficientin e kthimit” - sepse “kontributi i tyre nuk është dhuratë, por investim”. Kjo shihet sidomos te partitë e vogla, që nuk kanë mundësi për kthimin e këtij “investimi”, thotë Ramosaj. “Kthimi i këtij investimi mund të manifestohet në forma të ndryshme - që nga ndikimi në propozimin e ligjeve që favorizojnë interesat e donatorëve e deri te përfitimet konkrete, si: lejet e ndërtimit, koncesionet apo projektet publike që u shkojnë për shtat atyre apo grupeve të caktuara ekonomike”, shpjegon Ramosaj. Sipas Rregullores së KQZ-së, partitë politike kanë të drejtë të pranojnë kontribute shtesë për fushatat zgjedhore nga persona fizikë dhe juridikë.

Personat fizikë mund të dhurojnë deri në 2 000 euro, ndërsa subjektet juridike deri në 10 000 euro. Këto kontribute mund të jepen nga dita e shpalljes së zgjedhjeve deri në ditën e mbajtjes së tyre.

Raportet e fundit të publikuara nga KQZ-ja tregojnë se shumica e donatorëve janë persona fizikë. E përtej miliona eurove që partitë politike shpenzojnë për fushatat elektorale, organizimi i zgjedhjeve përbën, gjithashtu, një kosto të lartë për shtetin.

Sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, mbi 15.4 milionë euro janë ndarë nga buxheti i vitit 2025 për organizimin e zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit dhe atyre lokale të 12 tetorit.



# WESLEY CLARK KONFIRMOHET DËSHMITAR NË MBROJTJEN E THAÇIT

PRISHTINË, 24 TETOR - Gjenerali i pensionuar amerikan, Wesley Clark, do të dëshmojë në mbrojtje të ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, i cili ndodhet në paraburgim në Gjykatën Speciale në Hagë. Mbrojtja e Thaçit njoftoi se Clarku ka marrë autorizimin nga Qeveria e Shteteve të Bashkuara për të dëshmuar në mbrojtjen e Thaçit, i cili së bashku me tre ish-eporë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) po gjykohen në qytetin holandez për krime lufte. Clarku e udhëhoqi fushatën ajrore të NATO-s kundër cageve ushtarake serbe në vitin 1999. Fushata e sulmeve të NATO-s, e cila ka zgjatur 11 javë, nisi ta ndalë dhunën e forcave serbe kundër shqiptarëve në Kosovë, dhe ajo u ndërpre në qershor të vitit 1999, një ditë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës. Gjyqi ndaj Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit, të cilët i mohojnë akuzat për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit para dhe gjatë luftës së viteve 1998-1999, po shkon drejt përfundimit. Clarku do të jetë i fundit që do të dëshmojë në të mirë të Thaçit, mbrojtja e të cilit e filloi thirrjen e dëshmitarëve në shtator. Nuk është e qartë se kur saktësisht Clarku do të ulet në



bankën e dëshmitarit të mbrojtjes por, sipas mbrojtjes, ai ka njoftuar se nuk mund të dëshmojë para 18 apo 19 nëntorit. Mbrojtja e Thaçit kishte parashikuar paraprakisht se do t'i kryente dëshmitarët deri më 14 nëntor, por gjykata ka lejuar më shumë kohë. Gjithashtu mbrojtja i ka kërkuar gjykatës ta rezervojë të premten e 21 nëntorit si një ditë shtesë seance, në rast se kjo do të jetë e nevojshme për ta përmbyllur dëshminë e Clarkut. Deri tani në mbrojtje të Thaçit kanë dëshmuar ish-ndihmësi i sekretarit amerikan të Shtetit, James Rubin, këshilltari ligjor i delegacionit të Kosovës gjatë negociatave në Rambuje më 1999, Paul Williams, dhe ish-diplomati britanik John Stewart Duncan. Që të gjithë thanë në dëshmitë e tyre se Thaçi nuk kishte autoritet mbi UÇK. Gjykata Speciale e Kosovës e ka selinë në Hagë të Holandës dhe përbëhet nga gjyqtarë dhe avokatë ndërkombëtarë, pasi u themelua nga Kuvendi i Kosovës në vitin 2015, për t'i gjykuar rastet kundër ish-pjesëtarëve të UÇK-së sipas ligjit të Kosovës. Ajo pret që deri në fund të dhjetorit të përmbyllet gjykimi ndaj ish-krerëve të UÇK-së.

# KOSOVA NË UDHËKRYQ: QEVERI APO ZGJEDHJE TË PARAKOHSHME?

PRISHTINË, 24 TETOR - Më 26 tetor përfundon afati kushtetues 15 ditor për formimin e qeverisë së re. Lëvizja Vetëvendosje, partia e cila doli e para në zgjedhjet parlamentare të 9 shkurtit, të dielën pritet të matet nëse i ka numrat apo jo. Mandatari i kësaj partie, Albin Kurti, ditë më parë bëri me dije se ekziston mundësia që LV-ja të dështojë në formimin e institucioneve të reja. Ai vlerësoi se ka shumë vështirësi për t'i siguruar numrat për shkak, siç tha ai, "xhelozisë, inatit e cinizmit". Ai fajësoi ish-opozitën se nuk ka vullnet për formimin e qeverisë së re. Sipas tij, e vetmja zgjidhje janë zgjedhjet e parakohshme, raporton "albanianpost". Mandatari ka 15 ditë kohë për ta dorëzuar përbërjen e qeverisë dhe për të kërkuar miratimin e saj nga Kuvendi. Qeveria e propozuar duhet të sigurojë të paktën 61 vota nga 120 deputetë për t'u miratuar. Në rast se nuk arrihet kjo shumicë, presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka detyrimin që brenda 10 ditëve të zhvillojë konsultime të reja me partitë

dhe të vendosë për mandatarin me gjasat më të mëdha për formimin e qeverisë. Megjithatë, Partia Demokratike e Kosovës duket se nuk e ka ndër mend të tentojë t'i bëjë numrat për krijimin e institucioneve të reja. Nënkrjetarja e PDK-së, Vlora Çitaku, ka potencuar se PDK-ja ka kuptuar që ka mungesë të numrave dhe se zgjedhjet e reja janë të pashmangshme. Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, ka mohuar në mënyrë kategorike mundësinë e ndonjë kontakti apo bashkëpunimi me Lëvizjen Vetëvendosje për krijimin e institucioneve të reja. Ai ka theksuar se qëndrimi i LDK-së mbetet i pandryshuar dhe se të gjitha zërat për një koalicion të mundshëm janë spekulime. Ndërkaq deputeti i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Daut Haradinaj, ka deklaruar se partia e tij nuk do ta mbështesë Albin Kurtin për një mandat të ri në krye të qeverisë. Sipas Haradinajt, asnjë nga deputetët e AAK-së nuk do të japë votë për Kurtin, madje as nëse në këmbim do t'u ofrohej posti i



presidentit të vendit. Për zgjedhje të parakohshme është edhe nënkryetari i Kuvendit të Kosovës nga radhët e komunitetit serb, Nenad Rashiq, meqë, sipas tij, aktualisht nuk ka shumë gjasë për arritjen e një marrëveshjeje

për krijimin e qeverisë. Nëse zgjedhjet bëhen të pashmangshme, sipas Rashiqit, ato mund të organizohen në fund të janarit ose në fillim të shkurtit të vitit të ardhshëm. Nëse qeveria nuk mund të formohet as pas përpjekjes së

dytë, Kushtetuta kërkon shpalljen e zgjedhjeve të reja brenda 40 ditësh. Lëvizja Vetëvendosje, që doli e para nga zgjedhjet e 9 shkurtit, ka 48 deputetë në Kuvend. Asaj i duhen edhe 13 deputetë për ta formuar qeverinë me 61 vota.



## QKUK dhe shoqata 'Asvi' nga Italia diskutojnë rreth një marrëveshje bashkëpunimi

PRISHTINË, 24 TETOR - Përfaqësues nga Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (QKUK) pritën të premten në vizitë zyrtare delegacionin e shoqatës italiane ASVI (Associazione Solidarietà Volontariato Insieme) me seli në Milano. Delegacioni u kryesua nga Marinella del Passo dhe dr. Gabriele Vignati, kardiolog pediater. Përfaqësuesit e ASVI-së u pritën nga dr. Ardian Shefkui, u. d. drejtor

Shëndetësor në ShSKUK-së dhe ekipi i kardiokirurgëve, neonatologëve dhe anesteziologëve të QKUK-së: dr. Gazmend Spahiu, dr. Shpejtim Shurdhiqi, dr. Luan Morina, dr. Linda Kryeziu dhe Dardane Mehaj. Qëllimi i takimit ishte diskutimi i mundësisë së nënshkrimit të një marrëveshjeje bashkëpunimi ndërmjet QKUK-së dhe shoqatës ASVI, me synim themelimin e

njësisë së kardiokirurgjisë pediatrike në Kosovë si dhe trajnimin e stafit mjekësor të Kosovës në qendra të specializuara shëndetësore në Itali. Shoqata ASVI ka dhënë një kontribut të çmuar në Kosovë dhe në rajonin e Ballkanit që nga viti 1999, në fusha të ndryshme si ndihma humanitare, zhvillimi komunitar, mbështetja sociale dhe arsimore. Në fushën e



## UNICEF-I NË KOSOVË DHE BERZH-I NËNSHKRUAJNË MEMORANDUM MIRËKUPTIMI

PRISHTINË, 24 TETOR - Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZh) dhe UNICEF-i në Kosovë po bashkojnë forcat për ta mbështetur angazhimin e të rinjve në eficiencën energjetike, zhvillimin e shkathtësive dhe hartimin e politikave të bazuara në të dhëna, me qëllim që të arrihen rezultate konkrete për fëmijët dhe të rinjtë. Duke u mbështetur në partneritetin global mes UNICEF-it dhe BERZh-it, Memorandumi i Mirëkuptimit (MoU) i nënshkruar të premten në Prishtinë shënon fillimin e një përpjekjeje të koordinuar në Kosovë për të vendosur një

kornizë bashkëpunimi që synon angazhimin e të rinjve si agentë aktivë të ndryshimit në tranzicionin e gjelbër; ngritjen e shkathtësive të të rinjve, sipërmarrjes dhe kalimin drejt vendeve të punës të gjelbra; si dhe shfrytëzimin e ekspertizës së të dyja palëve për ta përmirësuar gjenerimin e të dhënave cilësore dhe analizave, duke nxitur rezultate me ndikim që fuqizojnë investimet në kapitalin njerëzor. Ky bashkëpunim synon të krijojë një model që bashkon qeverinë, sektorin privat, shoqërinë civile dhe të rinjtë në një kornizë të përbashkët për zhvillim të qëndrueshëm.



Kosova gjendet në një moment unik, me një popullatë të re në rritje, një strategji që avanco

objektivat për klimën dhe eficiencën energjetike, dhe me një rritje të fuqizimit të të rinjve

në tregun e punës dhe jetën qytetare. Përmes këtij partneriteti Kosova bëhet pioniere në Ballkanin Perëndimor, duke treguar se si iniciativat e fokusuara tek të rinjtë dhe të bazuara në prova, të harmonizuara me kornizat e investimeve të gjelbra, mund ta përshejtojnë përparimin. Ky memorandum bashkon mandatin e UNICEF-it për t'i promovuar të drejtat dhe mirëqenien e fëmijëve dhe të rinjve me ekspertizën dhe instrumentet financiare të BERZh-it në ekonominë e gjelbër, eficiencën e energjisë dhe investimet e qëndrueshme.

## ORGANIZOHET PUNËTORIA “ZBATIMI I LIGJIT PËR ZHVILLIM RAJONAL TË BALANCUAR DHE INICIMI I HARTIMIT TË PLANIT OPERACIONAL RAJONAL”

PRISHTINË, 24 TETOR - Agjencia për Zhvillim Rajonal - Perëndim, me mbështetje nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, në Pejë organizoi punëtorinë me temën “Zbatimi i Ligjit për Zhvillim Rajonal të Balancuar dhe inicimi i hartimit të Planit Operacional Rajonal”. Qëllimi i punëtorisë ishte informimi i përfaqësuesve të komunave të regionit të Perëndimit me bazën ligjore dhe aktet nënligjore që lidhen me Zhvillimin Rajonal të Balancuar, si dhe theksimi i rëndësisë së kësaj baze ligjore për krijimin e planit operacional për secilën komunë



veç e veç, edhe për mundësitë e bashkëpunimit në nivel regional në përgjithësi. Në këtë punëtori, e cila u udhëhoq nga strukturat e AZhR-së Perëndim, pjesëmarrësit u njoftuan edhe me organizimin e ardhshëm të AZhR-ve dhe funksionimin e tyre. Sipas organizimit të ri, nga pesë regjione ekzistuese do të krijohen shtatë regjione, ndërsa emërtimi i tyre do të jetë: Qendra Zhvillimore Rajonale (QZR). Gjithashtu, gjatë punëtorisë u paraqitën: Prioritetet zhvillimore të përcaktuara në strategjitë

kombëtare dhe rajonale në fushat e zhvillimit ekonomik dhe turizmit të qëndrueshëm; Prioritetet zhvillimore të identifikuar në planet zhvillimore komunale dhe strategjitë lokale në të njëjtat fusha. Përfaqësuesit komunalë të autorizuar kontribuan me identifikimin e prioritetëve zhvillimore të komunave të tyre, duke theksuar fushat me potencial për zhvillim të përbashkët rajonal. Në cilësinë e monitoruesit nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, në punëtori mori pjesë z. Shani Hamitaga, udhëheqës i Divizionit për Nisma Rajonale në MZHR.

## Memli Krasniqi: PDK-ja, partia më e votuar në Kosovë

PRISHTINË, 24 TETOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka thënë se pas përfundimit të numërimit të votave nga KQZ-ja, PDK-ja ka marrë mbi 187 500 vota. Në “Facebook”, Krasniqi ka thënë se qytetarët kanë folur qartë në këto zgjedhje. “PDK - partia më e

votuar në Kosovë! Pas përfundimit të numërimit të votave nga KQZ, me mbi 187,500 vota, qytetarët e Kosovës folën qartë edhe në këto zgjedhje lokale: besimi, organizimi dhe vizioni i Partisë Demokratike të Kosovës për zhvillim kanë fituar sërish. Ky rezultat është

dëshmi e punës sonë të përbashkët, e çdo kandidati, anëtar, aktivisti dhe qytetari që beson se Kosova mundet ma mirë. Faleminderit për çdo votë. Faleminderit për besimin tuaj. Puna jonë vazhdon. Në çdo komunë, për çdo qytetar”, ka shkruar Krasniqi.





Operacion i rrallë në spitalin e Pejës, hiqet me sukses cista gjigante te një 16 vjeçe

Pejë, 24 tetor - Spitali i Përgjithshëm në Pejë ka regjistruar një rast të rrallë kirurgjikal, ku një paciente 16-vjeçare është operuar me sukses për një cistë gjigante të shpretkës. Vajza, e lindur në vitin 2009, u paraqit në spital me dhimbje të barkut dhe një prominim nën harkun brinjor të majtë. Ekografia e abdomenit zbuloi një formacion cistik tumoral

me përmbajtje jo homogjene, i cili u konfirmua më pas nga tomografia kompjuterike (CT) si një masë 20x20 cm në shpretkë. Pas përgatitjeve preoperative dhe analizave laboratorike, u krye ndërhyrja kirurgjikale nën anestezion të përgjithshëm. Gjatë operacionit masa cistike u izolua dhe u hoq së bashku me shpretkën, pa dëmtuar organet përreth si lukthi,

pankreami, kolon, veshka e majtë, apo diafragma. Pacientja e përballoi mirë operacionin dhe periudhën post-operative në njësinë e kujdesit intensiv. Materiali i hequr është dërguar për ekzaminim histopatologjik për verifikim të mëtejshëm të natyrës së lezionit. Ky rast tregon përgatitjen dhe profesionalizmin e stafit kirurgjikal në Spitalin e



ISH-DEPUTETËT AUSTRIAKË VIZITOJNË UNIVERSITETIN E PRISHTINËS

**Qendresa RAMA**  
PRISHTINË, 24 TETOR - Një grup ish-deputetësh të Parlamentit Federal të Austrisë, politikanë dhe njerëz të angazhuar në çështje universitare e sociale, gjatë një vizite në Universitetin e Prishtinës shprehën gatishmërinë të ndihmojnë për forcimin dhe zgjerimin e mëtejme të lidhjeve të shkëlqyeshme në mes të UP-së dhe universiteteve e partnerëve të tjerë austriakë. Mysafirët u informuan se Universiteti i Prishtinës është institucioni i arsimit të lartë më i vjetri, më i madhi dhe më i suksesshmi i Kosovës dhe i rendituri më së larti në platformat e njohura ndërkombëtare nga të gjitha universitetet në gjuhën shqipe në Ballkan dhe në botë. Para ish-deputetëve austriakë u

treguan edhe sfidat dhe përpjekjet e vazhdueshme të menaxhmentit të UP-së për ndërkombëtarizim, përfshirje më të fuqishme të kërkimit shkencor në platformat e revistat prestigjioze botërore dhe vendosje të Kosovës në hartën globale të dijes dhe përpërimit njerëzor. Gjatë takimit u fol edhe për ndihmën e pakursyer austriake për UP-në dhe Kosovën që nga vitet '90, kur ky shtet pranoi diplomat e atëhershme të sistemit të arsimit të Kosovës, kur ai funksiononte në shtëpitë-shkolla, pas largimit të dhunshëm të nxënësve e studentëve nga objektet shkollore dhe universitare. U përmendën me respekt edhe personalitete austriake si p. sh. Alois Mock e Erhard Busek, të cilët mbështetën fuqishëm Kosovën e arsimit e saj si në periudhën e okupimit e



aparteidit të viteve '90, po ashtu edhe në kohën e pasçlirimit. Emrin e Erhard Busekut e mban sheshi pranë Bibliotekës Kombëtare “Pjetër Bogdani”. Delegacioni austriak i kryesuar nga prof. Josef Höchtl, në përbërje të të cilit ishin edhe dr.

Ernst Wurz, Margarete Scheuch, mag. Heinrich Scheuch, Stefanie Zobl, Franz Fuchs, Brigitte Wingelmayer, ing. Josef Wöginger, dr. Ernst Wunderbaldinger, di. Eugen Josef Sprenger, Maria Sprenger dhe Flamur Lladrovci, u prit nga

rektori, prof. Arben Hajrullahu, prorektorja për ndërkombëtarizim dhe shkëmbim akademik, prof. Rozafa Basha dhe prorektori për mësimdhënie, çështje të personelit akademik dhe botime, prof. Naim Jerliu. Një ditë më parë Rektoratin e Universitetit të Prishtinës e vizitoi edhe zëvendësambasadorja austriake në Kosovë, Clarissa Castek, ndërsa në nëntor të vitit të kaluar u zhvillua një takim i ambasadorit austriak në Kosovë, shkëlqesisë së tij, Georg Shchnetzer, me drejtuesit e UP-së. Universiteti, nga memorandumi i nënshkruar me Programin ShER - Arsimin e Lartë dhe Kërkimin e Qëndrueshëm në Kosovë, vazhdon të mbështetet nga shumë organizata dhe institucione të Austrisë.



“E BËRI KAUZËN E KOSOVËS PJESË TË NDËRGJEGJES EVROPIANE”, OSMANI NË BERLIN I JEP MEDALJE POLITIKANES GJERMANE

PRISHTINË, 24 TETOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, i ka dhënë Medaljen Presidenciale të Meritave politikanes gjermane Marieluise Beck, për të cilën ka thënë se kauzën e Kosovës e bëri pjesë të ndërgjegjes evropiane.

Medaljen asaj Osmani ia ka dhënë gjatë një takimi që ajo pati me mërgatën shqiptare në Berlin. “Në Berlin, së bashku me mërgatën tonë të jashtëzakonshme, kaluam një mbrëmje plot emocion e mirënjohje. Pata nderin t’i

dorëzoi Medaljen Presidenciale të Meritave znj. Marieluise Beck për mbështetjen e saj të palëkundur ndaj popullit të Kosovës - një grua që e bëri kauzën e Kosovës pjesë të ndërgjegjes evropiane”, ka shkruar Osmani në “Facebook”.

Gërvalla dhe ambasadori Reka presin në takim përfaqësues të Komunitetit Shqiptaro-Amerikan të fushës së arkitekturës

Prishtinë, 24 tetor - Në ambientet e Konsullatës së Përgjithshme të Republikës së Kosovës në Nju-Jork, ministria në detyrë e Punëve të Jashtme, Donika Gërvalla, ka pritur përfaqësues të komunitetit shqiptaro-amerikan të fushës së arkitekturës. Gërvalla ka thënë se pati një bisedë shumë miqësore e të përzemërt për kontributin e tyre

të jashtëzakonshëm për Kosovën. “Arkitektët tanë në Amerikë kanë ndërtuar karriera të suksesshme në zyra të njohura tashmë ndërkombëtarisht. Bashkëbiseduam për sfidat me të cilat përballen, idetë që i frymëzojnë dhe gatishmërinë për të dhënë më të mirën për vendin tonë. Me nisma të tilla duam të hapim rrugë bashkëpunimi, ku

idetë dhe përvoja të qarkullojnë lirshëm mes profesionistëve brenda dhe jashtë vendit. Faleminderit nga zemra arkitektëve tanë në mërgatë për punën, përkushtimin dhe dëshirën për të qenë edhe më pranë Kosovës. Jemi krenarë me ju dhe me mënyrën dinjitoze si na përfaqësoni”, ka shkruar Gërvalla në “Facebook”.





## MFPT hap thirrjen për OJQ që mbështesin familjet e cenueshme me pako ushqimore

PRISHTINË, 24 TETOR - Në kuadër të mbështetjes së vazhdueshme për familjet e cenueshme, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve njofton se është hapur thirrja për organizatat joqeveritare që të aplikojnë për mbështetje financiare e cila do të përdoret për ofrimin

e pakove ushqimore të familjet në nevojë. Të drejtë aplikimi kanë organizatat që veprojnë në komunitete dhe që ofrojnë shërbime ndaj kategorive të cenueshme të shoqërisë të cilat për të aplikuar duhet t'i bashkëngjisin dokumentet si në vijim: Certifikatën e

regjistrimit të organizatës në Republikën e Kosovës; Dëshminë mbi veprimtarinë e organizatës në mbështetje të kategorive të cenueshme; Planin e aktiviteteve që përfshin kapacitetet shërbyese; Numrin potencial të familjeve përfituese; Koston totale të pakove ushqimore

duke pasur parasysh se mbështetja është deri në 50 euro për pako; Listën e produkteve që përmban një pako ushqimore dhe çmimet përkatëse, duke pasur parasysh se së paku 70 % e produkteve duhet të jenë vendore. Aplikimet mund të dërgohen deri më 7 nëntor.



## RAPORTI I GAP-it ZBULON PABARAZI GJINORE DHE ETNIKE NË PROGRAMET E MBËSHTETJES PËR BIZNESE

Prishtinë, 24 tetor - Instituti GAP ka paraqitur raportin me temën “Forcimi i mbështetjes financiare për bizneset në pronësi të grave dhe pakicave etnike në Kosovë”. Në bazë të këtij raporti janë shfaqur shkeljet gjinore dhe etnike të programet e mbështetjes për biznese. Drejtori ekzekutiv në Institutin GAP, Blendi Hasaj, ka theksuar se fuqizimi ekonomik i grave dhe komuniteteve pakicë është i rëndësishëm dhe kërkon trajtim të duhur. “Fuqizimi ekonomik i grave dhe komuniteteve pakicë është një temë tejet e rëndësishme dhe trajtimi i duhur i saj kërkon pikërisht angazhim të vazhdueshëm, por edhe hulumtime që të kuptohet më saktësisht si shkalla aktuale e përkrahjes, nevoja për përkrahje, kapacitetet absorbuese të tyre, por edhe të mendohet e trajtohen tema edhe të llojit që flasin për sfidat dhe potencialet për rritjen e zgjerimin e tyre, të ndryshohet struktura aktuale ku 99 % e

bizneseve aktualisht janë biznese mikro, pra që të shkohet edhe një hap më tej. Në këtë aspekt, si institut jemi angazhuar tash e një kohë që të sjellim raporte që e japin një pasqyrë të saktë për numrin, profilin dhe shtrirjen e bizneseve të grave në Kosovë, nivelin e anëtarësimit, sfidat dhe përfitimet nga shoqatat dhe odat e bizneseve, qasjen në financa dhe problemet në sigurimin e kolateralit, se sa janë duke përfituar bizneset e grave nga tregtia elektronike dhe më shumë. Për ne, punimi që po e publikojmë sot është i rëndësishëm pikërisht në këtë aspekt, sepse jep shifra më konkrete për mbështetjen që gratë marrin nga fondet publike sikurse janë subvencionet dhe grantet, e që aktualisht është ndihmë e pamjaftueshme”, ka theksuar Hasaj. Anisa Zogaj, hulumtuese në Institutin GAP, ka paraqitur raportin, derisa ka theksuar se vetëm 7 % e bizneseve në pronësi



të grave dhe 8 % në pronësi të pakicave etnike kanë përfituar ndonjë lloj mbështetje. “Qëllimi kryesor i raportit është pasqyra e ndihmës që ofrohet në tri nivele: qendror, lokal dhe nga organizatat joqeveritare. Në anketën e përdorur për raport janë përfshirë gjithsej 757 biznese në pronësi të grave dhe komuniteteve pakicë, nga të cilat 399 biznese në pronësi të grave dhe 358 biznese të

pakicave. Të dhënat tregojnë pabarazi të vazhdueshme gjinore dhe etnike në programet mbështetëse të institucioneve publike. Sipas anketës së GAP-it, vetëm 7 % e bizneseve në pronësi të grave dhe 8 % në pronësi të pakicave etnike kanë përfituar ndonjë lloj mbështetjeje nga niveli qendror. Bazuar në të dhënat zyrtare, në skemat e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit

Rural, gratë përfituan mesatarisht vetëm 12 % të subvencioneve gjatë viteve 2018-2024. Po në programet e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë bizneset në pronësi të grave përfituan mesatarisht 16 % të granteve. Në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, përfshirja e bizneseve të grave nuk ka kaluar 40 %, ndërsa pjesëmarrja e pakicave etnike ka mbetur e ulët dhe e paqëndrueshme ndër vite. Në nivel lokal, përfshirja është ende më e kufizuar. Sipas të dhënave të anketës, vetëm 4 % e bizneseve në pronësi të grave dhe 8 % e bizneseve të pakicave kanë raportuar ndonjë formë mbështetjeje nga komunat ku veprojnë”, ka thënë Zogaj. Drejtori menaxhues nga Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK), Besnik Berisha, ka thënë se FKGK-ja nuk realizon financime, por është urë lidhëse e financimit.

## SHAHINI: MESAZHET NGA LONDRA JANË TË QARTA, RAJONI DUHET TA PËRSHPEJTOJË INTEGRIMIN EKONOMIK



PRISHTINË, 24 TETOR - Presidenti i Aleancës së Biznesit të Kosovës, Agim Shahini, ka thënë për “Kosovo online” se mesazhet nga Samiti i Ballkanit Perëndimor në kuadër të Procesit të Berlinit në Londër janë të qarta: rajoni duhet ta përshpejtojë integrimin ekonomik, ta forcojë besimin e ndërsjellë dhe ta vazhdojë rrugën drejt Bashkimit Evropian. Shahini ka theksuar se në Samit u vu theks i veçantë në tregun e përbashkët rajonal, tranzicionin e gjelbër dhe lidhjen më të mirë

të ekonomive. “Infrastruktura financiare dhe shkëmbimi i të dhënave të besueshme midis vendeve të rajonit janë një parakusht kyç për besim, investime dhe rritje të qëndrueshme. Kontributi ynë në këtë proces do të jetë formimi i Platformës së Byrosë së Kreditit të Ballkanit Perëndimor, zhvillimi i një kuadri rajonal për financimin e gjelbër dhe mbështetja e lëvizshmërisë së fuqisë punëtore përmes shërbimeve financiare”, ka thënë

Shahini. Ai shton se megjithëse ka pengesa, nga standardet e ndryshme rregullatore deri te mosmarrëveshjet politike, ai beson se rezultate konkrete mund të arrihen duke punuar së bashku para konferencës së ardhshme. “Aleanca e Biznesit të Kosovës do të mbetet një partnere e besueshme për institucionet dhe ekonominë në krijimin e një tregu rajonal të qëndrueshëm dhe të lidhur”, ka thënë Shahini.

## Qeveria në detyrë ndan 10 mijë euro për një konferencë dhe miraton raportin për buxhetin

PRISHTINË, 24 TETOR - Qeveria në detyrë e Republikës së Kosovës ka mbajtur mbledhje elektronike në të cilën ka ndarë mjete

financiare në shumë prej 10 000 eurosh me qëllim të promovimit të vendit për organizatën FLOSSK - Free Libre Open Source Software

Kosova për edicionin e 10 të Konferencës “Software Freedom Kosova (SFK)”, e cila do të mbahet më 24-26 tetor 2025 në FIEK, Prishtinë.

Gjithashtu, qeveria ka aprovuar raportin nëntëmujor të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2025.





# TRUMP BRAKTIS ‘KULAÇIN’ DHE PËRDOR ‘KËRBAÇIN’ NDAJ PUTINIT NË BISEDIMET PËR UKRAINËN



Nga Steve ROSENBERG,  
Redaktor i BBC për Rusinë

Një javë më parë pata ndjesinë e qartë se ishte si “Groundhog Day”, ose siç e quajnë rusët, “Dyen Surka”.

Në mes të kërcënimeve amerikane për t’i bërë presion Moskës — duke i premtuar Ukrainës raketa Tomahawk — Vladimir Putin dhe presidenti Donald Trump zhvilluan një telefonatë. Rezultati: u njoftua për një samit SHBA–Rusi në Budapest.

Në gushtin e kaluar, mes kërcënimeve për sanksione shtesë amerikane ndaj Rusisë, Putini u takua me të dërguarin e posaçëm të Trumpit, Steve Witkoff. Rezultati: u njoftua për një samit SHBA–Rusi në Alaskë. Por duket se “Groundhog Day” ka marrë fund.

Takimi në Alaskë u zhvillua me përgatitje minimale dhe me pak rezultate.

Ndërsa samiti në Budapest është anuluar. Madje mezi pati kohë të shpallej. Tani presidenti Trump e ka anuluar.

“Nuk ndjeva se do të arrinim aty ku duhet të arrijmë,” – u tha gazetarëve presidenti amerikan.

Dhe kjo nuk është e gjitha.

Më parë, Trump nuk i kishte përdorur kërcënimet për më shumë presion ndaj Rusisë, duke preferuar “kulaçin” ndaj “kërbaçit” në marrëdhëniet me Kremlinin.

Aktualisht ai e ka hequr kulaçin nga skena – ka vendosur sanksione ndaj dy kompanive të mëdha ruse të naftës, Rosneft dhe Lukoil.

Kjo gjë vështirë se do ta detyrojë Putinin të bëjë një kthesë në luftë, por është një shenjë e zhgënjimit të Trumpit ndaj mungesës së vullnetit të Kremlinin për kompromis apo lëshime për t’i dhënë fund luftimeve në Ukrainë.

## Reagimi rus

Presidenti Putin e quajti paketën e re të sanksioneve amerikane “një akt jo-miqësor” dhe “një përpjekje për t’i bërë presion Rusisë”.

“Asnjë vend dhe asnjë popull që respekton veten nuk vendos asgjë nën presion,” – tha ai.

Ish-presidenti Dmitry Medvedev ishte më pak diplomatik: “SHBA është armiku ynë, dhe ‘paqebërësi’ i tyre llafazan

ka hyrë plotësisht në rrugën e luftës me Rusinë,” – shkroi ai në rrjetet sociale. “Vendimet që janë marrë janë një akt lufte kundër Rusisë.”

Gazeta bulevardeske Moskovsky Komsomolets e përshkroi situatën me më pak dramë, por po aq negativisht, duke kritikuar “kapriçozitetin dhe paqëndrueshmërinë e partnerit tonë kryesor në negociata”.

## Çfarë ka ndryshuar?

Ndryshe nga hera e parë, kur Trump nxitoi drejt samitit të parë, këtë herë tregoi më shumë kujdes.

Ai i kërkoi Sekretarit të Shtetit Marco Rubio të përgatiste terrenin për samitin, përmes një takimi me ministrin e Jashtëm rus Sergei Lavrov, për t’u siguruar se kishte arsye për të udhëtuar në Budapest.

Por shpejt u bë e qartë se nuk kishte, dhe se një samit i ri nuk do të sillte ndonjë përparim. Rusia është rreptësisht kundër idesë së Trumpit për “ngrirjen” e vijave të frontit në Ukrainë. Kremlinin është i vendosur të marrë nën kontroll, të paktën, të gjithë rajonin lindor të Donbasit, një pjesë e madhe e të cilit tash-

më është pushtuar. Por presidenti Volodymyr Zelensky refuzon t’i dorëzojë Rusisë zonat që Ukraina ende kontrollon.

## Përfitimet dhe objektivat ruse

Moskës do t’i kishte pëlqyer një samit i dytë me SHBA-në.

I pari, në Alaskë, ishte një fitore diplomatike dhe politike për Kremlinin: prirja me tapet të kuq për Putinin në Anchorage simbolizoi rikthimin e Rusisë në skenën ndërkombëtare dhe dështimin e Perëndimit për ta izoluar.

Mediat shtetërore ruse e kanë shijuar idenë e një takimi në Europë me Trumpin, por pa praninë e Bashkimit Europian. Komentuesit rusë e përshkruan samitin e mundshëm në Budapest si “një shuplakë për Brukselin”. Megjithatë, pakkush besonte se ky takim do të sillte rezultatet që dëshiron Moska. Disa gazeta ruse madje kanë bërë thirrje që ushtria të vazhdojë luftën: “Nuk ka asnjë arsye që Moska të pranojë armëpushim,” – deklaroi dje Moskovsky Komsomolets.

Kjo nuk do të thotë se Kremlinin nuk dëshiron paqe — e dëshiron, por vetëm sipas kushteve të

veta, të papranueshme si për Kievin ashtu edhe për Uashingtonin.

## “Kushtet” e Rusisë

Këto kushte nuk lidhen vetëm me territorin: Moska kërkon që të adresohen “shkaqet rrënjësore” të luftës — një frazë që përdor për të përfshirë ndalimin e zgjerimit të NATO-s drejt lindjes. Gjithashtu besohet gjerësisht se Rusia synon ende ta rikthejë Ukrainën nën ndikimin e saj.

## Çfarë pritet nga Trump?

A është gati Donald Trump të shtojë edhe më shumë presion ndaj Rusisë? Ndoshta po. Por po aq e mundshme është që një mëngjes të zgjohemi dhe të gjendemi sërish në “Groundhog Day”.

“Në lojën e tërheqjes së litarit mes Trumpit dhe Putinit, Rusia po udhëheq sërish,” shkroi Moskovsky Komsomolets pas njoftimit të samitit të Budapestit, duke vazhduar më tej “Në javët para takimit, Trump do të tërhiqet në drejtimin e kundërt nga telefonatat dhe vizitat evropiane. Pastaj Putini do ta tërheqë sërish në anën tonë.”



# SI E ZBËRTHEU NIÇJA TË MIRËN DHE TË KEQEN NË ‘GJENEALOGJINË E MORALITETIT’

A është moralisht e mira vërtet “e mirë”, apo thjesht një mjet kontrolli? Në “Gjenealogjinë e Moralitetit”, Niçja sfidon gjithçka që mendojmë se dimë

Ne e ndërtojmë jetën tonë mbi bazën e moralit, por a jemi ndalur ndonjëherë të pyesim nga vjen ai?

Në “Gjenealogjinë e Moralitetit”, Niçja analizon se çfarë ne zakonisht konsiderojmë si të mirë dhe të keqe, me synimin për t’i çmontuar këto koncepte. Ky veprim revolucionar, botuar për herë të parë më 1887, kundërshton idenë se vlerat morale janë të dhëna nga lart apo se mund të nxirren nga arsyeja. Përkundrazi, Niçja pohon se ato burojnë nga konfliktet e pushtetit, nga mënyrat sesi njerëzit janë manipuluar psikologjikisht që t’i pranojnë, dhe nga ndjenjat e thella të pakënaqësisë e mërisë. Le t’i eksplorojmë me radhë. Nga pyetja “Çfarë është e drejtë?” te “Nga vjen morali?”

Filozofët përpara Niçes ishin përpjekur të përcaktonin se çfarë duhet të jetë morali – qoftë ai i arsyes (sipas Kantit) apo i dobisë (sipas Bentham dhe Mill). Por Niçja e ktheu pyetjen përmbys: nuk pyeti më çfarë është e drejtë, por nga vjen vetë morali.

Sipas tij, vlerat nuk janë universale apo absolute. Ato janë produkte të marrëdhënieve të pushtetit, të psikologjisë dhe të historisë. Ky është qëndrimi genealogjik i Niçes – vëzhgon sesi morali evoluon në kohë, pa supozuar ekzistencën e një morali të përgjithshëm.

Ashtu si Darvini e pa evolucionin e specieve për të mbijetuar, Niçja besonte se edhe vlerat evoluojnë brenda konteksteve shoqërore dhe historike. Vlerat e lashta të kulturave luftëtare – fuqia, krenaria, trimëria – u hodhën tutje nga vlerat fetare që promovuan përlësinë, nënshtrimin dhe fajin.


## Dy moralitete: ai i Zotërinjve dhe ai i Skllervëve

Zbulimi radikal i Niçes ishte se morali nuk është dhuratë nga Zoti apo nga arsyeja – është krijim i të pushtetshmëve për t’u shërbyer interesave të tyre.

Pra, vlerat tona të sotme mund të mos jenë aq “të natyrshme” apo “të mira” sa mendojmë. Dhe nëse njerëzit e shpikin moralin, a kemi të drejtë ta sfidojmë dhe ta rishkruajmë?

Në libër, Niçja ndan moralin në dy kampe: Morali i Zotërinjve dhe Morali i Skllervëve – lindur nga dy lloje njerëzish të ndryshëm.

Morali i Zotërinjve vjen nga të mëdhenjtë, të fortët dhe të



pushtetshmit – aristokracia, sundimtarët, luftëtarët. Për ta, “e mira” ishte ajo që lidhej me forcën, guximin, shëndetin, fuqinë. Dobësia dhe dështimi ishin “të këqija”. Mendo për heronjtë grekë si Akili – ambiciozë, krenarë, të pamposhtur.

Morali i Skllervëve, përkundrazi, lindi nga të dobët, të shtypurit, të hidhëruarit. Ata e përmbysën moralin: dobësia u bë virtyt, vuajtja u bë shenjtëri, nënshtrimi u bë mirësi.

Përlësia, butësia dhe bindja u ngritën në pedestal – vlera që i përshtateshin të pafuqishmëve, por që kufizonin energjinë njerëzore.

## Krishtërimi – fitorja përfundimtare e moralit të skllervëve

Niçja e pa Krishtërimin si triumfin përfundimtar të moralit të skllervëve. Krenaria u kthye në mëkat, fuqia në mizori, vuajtja në shpëtim. Në vend që të nderoheshin heronjtë, morali nisi të nderonte martirët.

Dhe pyetja që ai ngre mbetet therëse: A janë vlerat tona vërtet tonat, apo i kemi trashëguar verbërisht nga një moral që synon të na dobësojë?

## Mëria e brendshme e të dobtëve

Niçja e quajti këtë ndjenjë “ressentiment” – një mëri e thellë, jo thjesht xhelozia apo zemërim, por urrejtje e fshehtë ndaj fuqisë, që i shtyn të dobët të shpikin moralin e vet. Ata nuk

pranojnë vendin e tyre – e përmbysin sistemin: e bëjnë mjerimin virtyt dhe fuqinë mëkat.

Në Romën e lashtë, virtyti ishte forca, heroizmi dhe pushtimi. Por me përhapjen e Krishtërit, këto u shpallën të këqija: krenaria u bë ves, përlësia u bë virtyt, dhe martirizimi u shenjtërua. Morali nuk krijohet më nga të fuqishmit, por nga ata që e urrenin pushtetin.

## Aktualiteti i Niçes: nga politika te kultura e viktimës

Kjo analizë nuk i përket vetëm historisë. Niçja do të thoshte se edhe sot, lufrat ideologjike, kulturat e viktimizimit dhe konfliktet politike ndjekin të njëjtat dinamika.

Shumë lëvizje moderne e ndërtojnë “mirësinë” e tyre mbi hidhërimin ndaj pushtetit, duke e kthyer dobësinë në një formë të re force.

Kështu, Niçja pyet: A po i ndërtojmë vlerat tona mbi fuqinë, apo po e lëmë hidhërimin të na verbojë?

## Faji dhe “ndërgjegjja e keqe”

A të ka ndodhur ndonjëherë të ndihesh fajtor për diçka, edhe pse s’ke bërë asgjë? Niçja thotë se kjo “ndërgjegje e keqe” nuk është natyrore – është e mbjellë nga shoqëria.

Në fillimet e njerëzimit, morali nuk kishte lidhje me fajin e brendshëm, por me shpagimin. Nëse i bëje dëm dikujt, nuk

ndiheshe fajtor – paguaje dëmshpërblim. Por me kalimin e kohës, dënimi u kthye nga jashtë në brenda. Shoqëria filloi të të kontrollonte përmes vetëdijes. Ligjet, feja, normat shoqërore u bënë pjesë e brendshme e njeriut.

Krishtërimi e thelloi këtë: tani njeriu nuk duhej vetëm të paguante, por të ndjente faj shpirtëror, si mëkatar që duhej të vuante për t’u pastruar. Faji u kthye në instrument kontrolli. Edhe Frojdi më vonë e përshkroi diçka të ngjashme me konceptin e tij të “super-egos” – një zë i brendshëm që na ndalon, që na bën të ndjejmë turp e faj.

Por Niçja pyet: A është ndjenja e fajit vërtet morale, apo thjesht një mënyrë për të na mbajtur të nënshtruar?

## “Forca e vullnetit”: alternativa e Niçes

Sipas Niçes, moralet ekzistuese shpesh promovojnë vuajtjen, sakrificën dhe mohimin e kënaqësisë – ai i quajti këto “vlera asketike.” Nga murgjit fetarë që kërkonin pastërti përmes agjërit, te profesionistët modernë që besojnë se ndjenjat janë pengesë për arsyen – të gjithë ndjekin të njëjtin ideal: nënshtrimin e jetës.

Por Niçja akuzon këta “predikues të dhimbjes” se na kanë mashtruar të gjithëve.

Këto vlera nuk e përmirësojnë jetën – e bëjnë njeriun të sëmure shpirtërisht dhe të ndarë nga natyra e tij krijuese.

Në vend të kësaj, ai propozon forcën e vullnetit – forcën për të

krijuar, për t’u rritur, për të tejkaluar veten.

Jo të shtypësh dëshirat, por t’i shndërrosh në energji ndërtuese. Edhe sot kjo mbetet aktuale. Nga ekstremet e dietave, te mënyrat e jetesës minimaliste apo ideologjitë që glorifikojnë “vuajtjen për një kauzë”, Niçja do të pyeste: A po e kufizojmë veten ngaqë ndihemi të fuqishëm ta bëjmë, apo po ndjekim urdhra që na e imponojnë këtë dhimbje?

## Trashëgimia e Niçes

“Gjenealogjia e Moralitetit” nuk është thjesht një libër filozofie – është një tronditje e themeleve të moralit. Ajo ndryshoi mënyrën si mendojmë për të mirën dhe të keqen.

Filozofët ekzistencialistë dhe postmodernistë u frymëzuan nga ai: Fuko përdori qasjen genealogjike për të analizuar si funksionon pushteti në institucione; Delez tregoi se si morali formëson individin; Derrida pyeti nëse ekziston ndonjë e vërtetë morale e pandryshueshme.

Në psikologji, Frojdi dhe Niçja panë fajin si produkt të brendshëm të shoqërisë, ndërsa Jungu e pa atë si mundësi për njohje të vetvetes – proces që e quajti “individuum”.

Por idetë e Niçes mbeten të debatueshme. Disa mendojnë se ato çojnë në relativizëm moral – që nuk ekziston më as e drejta dhe as e gabuara.

Të tjerë frikësohen se mund të prodhojnë egoizëm ekstrem, ku njeriu mendon vetëm për veten. Megjithatë, librat e tij lexohen ende, sepse ngrejnë pyetjen më thelbësore: Pse i besojmë vlerave vetëm sepse janë të vjetra?


## Çfarë mbetet pas?

Niçja na tregon se idetë e lashta për të mirën dhe të keqen lindën nga fuqia dhe afirmimi i jetës, por u zëvendësuan nga një moral që glorifikon fajin dhe kontrollin.

Ne e kemi trashëguar këtë mënyrë të të menduarit, shpesh pa e kuptuar. Në vend që të na nxisë të zhvillohemi, morali shpesh na urdhëron të qëndrojmë të bindur dhe të frenuar.

Pra, pyetja e fundit e Niçes është kjo: A jemi vërtet njerëz të lirë, apo jemi ende të mësuar të kemi frikë nga potenciali ynë – si një kafshë që ndalohet të bëjë truket e saj, sepse çdo herë që përpiket, dikush e tremb? / bota.al





## Xhudistët e rinj nga Kosova sfidojnë Evropën në Kupën për kadetë në Slloveni

**PRISHTINË, 24 TETOR** - Federata e Xhudos e Kosovës, ka njoftuar se ekipi kosovar i përbërë nga tre xhudistë të rinj do të marrë pjesë në

Kupën Evropiane për Kadetë që do të mbahet sot (e shtunë) dhe nesër (e diel), në Kranjska Gora të Sllovenisë. Sipas njoftimit, Kosova

garon me Jon Kukën (-55 kg), Roni Reshitajn (-66 kg) dhe Milot Gashin (-66 kg). Në këtë kampionat do të marrin pjesë 432 garues/e, nga katër

kontinente dhe 21 shtete. Bashkë me xhudistët kosovarë ka udhëtuar edhe trajnerja, Majlinda Kelmendi.



## DRITA VAZHDON E PAMPOSHTUR NË LIGËN E KONFERENCËS

**PRISHTINË, 24 TETOR** - Kampionia e Kosovës në futboll, Drita, ka arritur të sigurojë edhe një pikë të vlefshme në fazën e grupeve të Ligës së Konferencës të UEFA-s, duke barazuar 1:1 me skuadrën qipriote Omonia, në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" në Prishtinë. Ndeshja i ka takuar xhiros së dytë të kësaj gare evropiane, ndërsa Drita ka zhvilluar një tjetër paraqitje dinjitoze. Drita ka kaluar në epërsi në

minutën e 12-të, kur Arb Manaj ka shënuar me kokë pas një harkimi të saktë nga Besnik Krasniqi. Megjithatë, në sekondat e fundit të pjesës së parë, Giannis Masouras ka barazuar shifrat në 1:1 pas një goditjeje nga këndi. Në pjesën e dytë, Drita ka vazhduar me lojë të organizuar dhe me disa tentativa për të gjetur golin e fitores, por ndeshja u mbyll pa fitues. Ky është barazimi i dytë radhazi për skuadrën

gjilanasë në këtë garë, pas rezultatit identik 1:1 në ndeshjen e parë kundër KuPS-it në Finlandë. Me këtë pikë, Drita e konfirmon edhe një herë se përfaqëson me dinjitet futbollin kosovar në arenën ndërkombëtare, duke mbetur e pamposhtur pas dy ndeshjeve të para në fazën e ligës. Ndeshjen e radhës në Ligën e Konferencës, Drita do ta zhvillojë më 6 nëntor në Irlandë kundër Shelbourne.



## KAMPIONI KUNDËR NËNKAMPIONIT

**PRISHTINË, 24 TETOR** - Superliga e Kosovës në basketboll vazhdon të dhurojë sfida shumë interesante. Derbi i javës zhvillohet nesër (e diel), ku përballen kampionia Trepça dhe nënkampioni Bashkimi. Duetet e edicionit të kaluar ishin të jashtëzakonshme, me gjashtë super finale të zhvilluara, që ngritën adrenalinën në maksimum. "Xehetarët" fituan 4:2 serinë finale. Të dy skuadrat marrin pjesë në grupet e FIBA Europe Cup, duke e bërë këtë sfidë evropiane në "Minatori". "Xehetarët" kanë një fitore e një

humbje, kurse "Portokallezinjtë" e nisën edicionin me dy fitore. Java e tretë fillon me përballjen Bora - GO+ Peja. Prishtinasit kanë dy humbje në dy ndeshje, kurse pejanët dy fitore në dy ndeshje. Takimi zhvillohet në "Minatori" të Mitrovicës. Rahoveci 029 debuton sot (e shtunë) në shtëpi në elitën e basketbollit, ku e pret Sigal Prishtinë, që ka dy fitore në dy ndeshje të zhvilluara, kurse "Vreshtarët" kanë një fitore e një humbje. Të dielën përballen skuadrat që ende nuk dinë për fitore në këtë edicion Golden Eagle Ylli dhe

Vëllaznimi. Të dy skuadrat kërkojnë fitoren e parë këtë edicion.

### SUPERLIGA E KOSOVËS NË BASKETBOLL - JAVA 3

**E shtunë**  
16:00 Bora - GO+ Peja  
19:00 Rahoveci 029 - Sigal Prishtina

**E diel**  
17:00 Golden Eagle Ylli - Vëllaznimi  
19:00 Trepça - Bashkimi



## PËRVEÇ BARCELONËS, EDHE TRE GJIGANTËT ANGLEZË INTERESOHEN PËR FISNIK ASLLANIN



**PRISHTINË, 24 TETOR** - Pas Barcelonës edhe disa skuadra tjera janë futur në garë për shërbimet e sulmuesit të Kosovës, Fisnik Asllani. Është bërë me dije se Barcelona po rivalizohet nga tri skuadra të Premier Leagues për

sulmuesin kosovar, i cili është pjesë e skuadrës së Hoffenheimit. Aston Villa, Chelsea dhe Tottenhami, janë skuadrat që kanë shprehur interesim për shërbimet e Asllanit, të cilin po e shohin si përforcim të duhur për sulmin.

Asllani 23-vjeçar para fillimit të këtij sezoni u kthye tek Hoffenheimi pas huazimit të Elversbergu dhe në Bundesligë ka treguar formë të mirë. Ai ka shënuar 4 gola në 7 ndeshje kampionale, ndërsa me Hoffenheimin ka rinovuar

kontratën deri në verën e vitit 2029. Kartoni i Asllanit, aktualisht vlerësohet mbi 10 milionë euro dhe duke pasur parasysh interesimin e madh nga skuadrat tjera, largimi i tij në fund të sezonit nga ekipi gjerman është më se i mundur.

## Messi vazhdon edhe për tri vjet me Inter Miamin

Miami, 24 tetor – Superylli Lionel Messi e ka vazhduar kontratën me Inter Miamin. Tetë herë fituesi

i "Topit të Artë" ka nënshkruar një kontratë të re me ekipin nga MLS, që zgjat deri në dhjetor të vitit

2028. Argentinasi është dukshëm futbollisti më i mirë në këtë ligë me statistika të jashtëzakonshme.

Pra, për edhe të paktën tri vite të tjera do ta shohim Messin në fushat e blerta.





NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Auto Servis Dafi” SH.P.K. pronar Valbone Bekteshi me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812239178 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Auto Servis Dafi” D.O.O. Valbone Bekteshi Gnjlane donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812239178 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Auto Servis Dafi” L.L.C. Valbone Bekteshi with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 812239178 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Risa Trade” Sh.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb UNIK: 812139526 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Risa Trade” D.O.O. od Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812139526 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Risa Trade” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 812139526 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Shtëpia Botuese Artistike Drenishta” SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810505109 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Shtëpia Botuese Artistike Drenishta” D.O.O. Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810505109 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Shtëpia Botuese Artistike Drenishta” L.L.C. with headquarters Prishtina, has come to the decision to quit its business: 810505109 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Prime Invest Group” SH.P.K. me numër Unik Identifikues: 812182450, Prishtinw me pronar Murat Kuka dhe Shaban Çetaj bënë shpallje në gazetë për zvogëlim të kapitalit nga 750.000 Euro në 170.000.

- Samile Mullaibrahimi shpall të pavlefshme diplomën e sh.m të mjekësisë “Hysni Zajmi”.

- Muharrem Shala shpall të pavlefshme diplomën si dhe dëftesat e shkollës fillore “Mustafa Bakija”.

- Albatros Manxhuka shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e shkollës së mesme “Gjon Nikoll Kazazi”.

- Shqiprim Morina shpall të pavlefshme diplomën dhe dëftesat e shkollës së mesme “12 Maji”.

- “Fire Protection Agency Rifiel Action” L.L.C. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330530669.

- Bekim Selimaj shpall të pavlefshme diplomën e Kolegjit Biznesi.

- Meritë Bytyqi shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Luciano Motroni” Prizren.

- Blend Mustafaj nga Deçani, shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 si dhe diplomën e sh.m. mjekësisë “Htsni Zajmi”.
- Simunida Maksuti shpall te pavlefshme dëftesat e kl.10.11.12.13. si dhe Diplomën e sh.m. Prof. “Gjon Nikolle Kazazi” Teknologji Informative Gjakove.

- NNSH “Meridian”, shpall të pavlefshme numrin UNIK të biznesit: 810227406, të lëshuar nga ARBK.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)





ROYAL CROWN

**RC**  
cola

# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvadorenas S.A. Guatemala, Quality
- ★ Fluidi S.p.a. Kosova, Quality
- ★ Industria e Comercio de Bebidas Foz de Lido Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L Lebanon, Sales
- ★ Koteln Československo a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zolal CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Portea Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

RC  
cola

Philadelphia, Pennsylvania, USA



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

